



# **BASHKIA MIRDITE**

## **RAPORTI I MONITORIMIT TE ZBATIMIT TE BUXHETIT (Analiza vjetore)**

# **2022**

## PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	2
2. Realizimi i buxhetit të vitit 2022.....	3
3. Realizimi i te ardhurave të Bashkisë Mirditë nga burimet e veta për vitin 2022.....	6
4. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2022 .....	21
4.1 Transferta e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta vendore .....	34
4.2 Transferta e pakushtëzuar sektoriale .....	36
4.3 Transferta e kushtëzuar.....	40
5. Realizimi i investimeve.....	44
6. Vetëvlerësimi financiar për vitin 2022 për situatën e gjendjes financiare të Bashkisë Mirditë.....	46
7. Analiza e funksioneve .....	48
7.1 Funkzioni: Shërbime të Përgjithshme Publike .....	48
7.2 Funkzioni : Arsimi.....	59

## 1. Hyrje

Sipas Regjistrisë të Gjendjes Civile 2014 Mirdita ka një popullsi prej 37,384 banorësh, dhe një sipërfaqe prej 869.71 km<sup>2</sup>, me densitet prej 42.98 banorë/km<sup>2</sup>.

Bashkia Mirditë gjendet midis koordinatave gjeografike 41° 43' e 41° 59' gjerësi veriore dhe 19° 43' e 20° e 12' gjatësi lindore, duke u kufizuar në veri me Bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me Bashkinë e Kukësit dhe Dibres. Në jug-lindje kufizohet me bashkinë Dibër, në jug me Bashkinë Mat dhe Kurbin ndërsa në jug-perëndim me bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Rrëshenit.

Bashkia përfshin 4 qytete dhe 81 fshatra, të shpërndara në 7 njësitë administrative përbërëse të saj: Rrësheni, Rubiku, Selita, Kthella, Fani, Oroshi dhe Kaçinari. Bashkia është aktualisht pjesë e qarkut të Lezhës.

### Klima:

Klima është mesdhetare kodrinore, paramalore e malore. Bimësia është mjaft e pasur dhe përbëhet nga shkurre, dushqe, pyje të përzier, ahishte e kullota malore. Bimët mjekësore janë mjaft të përhapura. Nga pikpamja fizike territori karakterizohet nga formacione malore, lugina, pllaja, fusha, fushëgropa. Lartësia mesatare shkon 557 m mbi nivelin e detit, maja më e lartë është M. Kunorë (Selitë) (Jo Kunora, Mali i Dejes) 2121 m. Përshkohet nga lumenjtë Fani i Madh, Fani i Vogël, Uraka. Këta lumenj si dhe përrunj të tjerë malorë, kanë jo vetëm kapacitete prodhuese energjetike por edhe për kultivimin e faunes ujore.

### Ekonomia:

Zona ka profil ekonomik kryesisht bujqësor dhe blegtoral, ndërkohë që vreshtaria po kthehet në një aktivitet mjaft të përhapur duke krijuar kushte shumë të mira për zhvillimin e agrobiznesit e agroturizmit. Ka pasuri të mëdha nëntokësore, veçanërisht bakër, pirit, krom, të cilat sollën krijimin e katër qyteteve të lidhura me industrinë minerare. Pjesa më e madhe e kësaj industrie aktualisht është jashtë funksionit. Kjo është një nga arsyet që Mirdita shënoi një ndër nivelet më të larta të migrimit të brendshëm si dhe të emigrimit përgjatë 25 viteve të fundit. Per arsye se sipërfaqja e pyjeve në bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore, problemet ekologjike të zonës, janë kryesisht të lidhura me pyjet. Trashëgimia kulturore dhe etnografike është mjaft e larmishme dhe unike.

Pas ndërtimit të autostradës A1, Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi dhe si porta natyrore hyrëse për në Kosovë. Ndërtimi i Rrugës së Kombit megjithëse përmirësoi volumin e levizjes dhe cilësinë e udhëtimit, solli një impakt modest për zhvillimin social-ekonomik të zonës, e cila ka nevojë për impulse të reja zhvillimi.

## **2. Realizimi i buxhetit të vitit 2022**

Realizimi i buxhetit të vitit 2022 është bërë duke respektuar nenin 64 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , ligjin nr. 68/2017 date 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore “, ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligji nr 137, datë 16.12.2020 “Buxheti i vitit 2021”, udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të qeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” dhe VKB nr. 125 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 të Bashkisë Mirditë”, i ndryshuar.

Bashkia Mirditë, administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve buxhetore të miratuara, si më poshtë:

### **Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE**

Programi - 01110: Planifikim menaxhim administrim

Programi - 01120: Çeshtje Financare dhe Fiskale

Programi - 01170: Gjendja civile

### **Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE**

Programi - 03140: Sherbimet policise vendore

Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile”

### **Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE**

Programi - 04130: Mbeshtetje per zhvillim ekonomik

Programi - 04220: Sherbimet bujqesore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Programi - 04240: Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit

Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural

Programi - 04760: Zhvillimi i turizmit

### **Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT**

Programi - 06140: Planifikim urban vendor

Programi - 06260: Sherbimet Publike vendore

Programi - 06330: Furnizimi me uje

Programi - 06370: Ujesjelles dhe Kanalizime

### **Funksioni 8 ARGETIMI KULTURA DHE FEJA**

Programi - 08130: Sport dhe argetim

Programi - 08220: Trashegimia kulturore, eventetartistike dhe kulturore

Programi - 08230: Integrimi Evropjan & ndihmes se huaj

### **Funksioni 9 ARSIMI**

Programi - 09120: Arsimi baze perfshire arsimi parashkollor

Programi - 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem

Programi - 09240: Arsimi profesional

### **Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE**

Programi - 10140: Punonjesit social

Programi - 10430: Kujdesi social per familjet dhe femijet

Burimet e financimit te buxhetit të Bashkisë, vijnë nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione,dhe te ardhura qe trashegohen.

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara, transferta specifike për mbrojtjen civile dhe transferta e kushtëzuar.

**Buxheti i vitit 2022, në total në 000/leke me të gjitha burimet e financimit, paraqitet si më poshtë:**

000/lekë						
Nr	BURIMET E FINANCIMIT	Plani Fillestar 2022	Plani Korrigjuar 2022	FAKTI 2022	Diferenca	Realizimi ne %
<b>I</b>	<b>TE ARDHURAT E VETA</b>	<b>75,000</b>	<b>75,000</b>	<b>63,881</b>	<b>11,119</b>	<b>85%</b>
1	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	18,391	18,391	15,576	2,815	85%
2	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	17,314	17,314	19,724	-2,410	114%
3	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	35,374	35,374	25,973	9,401	73%
4	TE ARDHURA TE TJERA	3,921	3,921	2,608	1,313	67%
<b>III</b>	<b>TRANSFERTAT</b>	<b>381,252</b>	<b>2,012,097</b>	<b>1,902,152</b>	<b>109,945</b>	<b>95%</b>
1	Transferte e Pakushtezuar	207,162	236,423	188,222	48,201	80%
2	Transferte e Pakushtezuar Sektoriale	168,474	171,024	149,606	21,418	87%
3	Transferte specifike	5,616	5,746	5,519	227	96%
4	Transferte e kushtezuar	0	1,598,904	1,558,805	40,099	97%
<b>IV</b>	<b>TE TRASHEGUARA</b>	<b>0</b>	<b>26,287</b>	<b>26,287</b>	<b>0</b>	<b>100%</b>
1	Transferte e pakushtezuar	0	9,803	9,803	0	100%
2	Transferte e Pakushtezuar Sektoriale	0	14,976	14,976	0	100%
3	Te ardhura	0	1,508	1,508	0	100%
<b>TOTALI VITI 2022</b>		<b>456,252</b>	<b>2,113,384</b>	<b>1,992,320</b>	<b>121,064</b>	<b>94%</b>

Buxheti i Bashkisë Mirditë, për periudhën e 12 mujorit për vitin 2022, duke përfshirë të gjitha burimet e financimit, është planifikuar në vlerën 2,113,384 mijë lekë.

### **3. Realizimi i te ardhurave te Bashkisë Mirditë nga burimet e veta për vitin 2022**

Bashkia Mirditë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve. Financimin e buxhetit të saj, bashkia e realizon nga:

- a.** burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen;
- b.** grantet e projekteve të huaja dhe donacionet;
- c.** burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuar dhe transfertat specifike.

Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulëta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Objektivat kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet Zyrave të Integruara me Një Ndalese. Shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin. Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbështetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulancat etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimeve nga viti në vit. Këto politika të lehtësimit fiskal dhe inçentives, shoqëruar paralelisht me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Është mundur të bëhet implementimi i regjistrave të sakte elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju

kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve taksapaguese. Grupet e terrenit ushtruan verifikime te vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultate të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave. Kujdes të veçantë gjatë vitit 2022 iu kushtua përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, saktësisht dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Mosrealizimi i planit të të ardhurave të vitit 2022 ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila është realizuar në masën 53 % për arsye të mospagesës së taksës ndikimit në infrastrukturë pasi nuk ka patur leje ndertimi sic eshte parashikuar te jete, për legalizimet e ndërtimeve pa leje, mosrealizimi i takses mbi ndertesat ne masen 25% si rezultat i mospageses nga familjet ne fshat dhe mos identifikimi i ndertesave ne fshat per shkak te levizjes popullore dhe emigracionit, mosrealizimi i taksës së tokës bujqësore e cila është realizuar në masën 15 %, si rrjedhim i mosregjistrimit të pronave të tokës bujqësore, problemeve me Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi. Per vitin 2022 sipërfaqja totale e tokes bujqesore eshte 6318 ha ku sipërfaqja e ndarë është 3847 ha ku 36 % e sipërfaqes është pandare, mosrealizimi i shërbimeve publike në masën 27% kjo si rezultat i mospageses kësaj tarife nga familjet ne fshatra ku ofrohet ky shërbim.

Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues kemi patur gjatë vitit 2022 rritje të disa treguesve fiskale si dhe kjo falë rakordimit të përmujshëm me :

-Drejtorinë e pergjethshme te transportit rrugor për taksesn vjetore të qarkullimit të mjeteve të përdorura.

-DPT për tatimin mbi të ardhurat personale

Më tej performanca ka vijuar dhe me ndjekejen dhe dhenien me qira të aseteve dhe kullotave që për vitin 2022 kishim nje realizim në masën 100%.

Kjo garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Bashkia Mirditë me burimet e veta arriti të menaxhojë situatën dhe të ofrojë shërbimet e duhura ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj.

## **Kategorizimi i të ardhurave**

- Taksat vendore:
  - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
  - Taksa e ndikimit në infrastrukturë
  - Taksa e fjetjes në hotel
  - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5-8 milion, agjent DRT Mirditë
  - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- Taksat e ndara:
  - Taksa vjetore e e qarkullimit te mjeteve
  - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ASHK



- Taksa e rentës minerare
  - Tatimi mbi të ardhurat personale
- Tarifat vendore
- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të shërbimit administrativ
  - Tarifa për parkimin e mjeteve e licensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa për zënien e hapësirave publike
  - Tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj
- Të ardhura të tjera:
- Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
  - Të ardhura nga kundravajtjet administrative
  - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve
  - Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime
  - Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
  - Te ardhura nga donacione/sponsorizime
  - Të ardhura te tjera (komision si agjent tatimor).

## Realizimi i të ardhurave nga të ardhurat vendore 2022

000/leke

	Plan	Fakt
<b>Të ardhura nga taksat</b>	18,391	15,576
<b>Të ardhura nga taksat e ndara</b>	17,314	19,724
<b>Të ardhura nga tarifat</b>	35,374	25,973
<b>Të ardhura nga burime të tjera vendore</b>	3,921	2,068
<b>Totali</b>	<b>75,000</b>	<b>63,881</b>

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2022 arritën vlerën 63,881 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga taksat e ndara, të ardhura nga tarifat dhe të ardhura të tjera.

Theksojme se të ardhurat e datës 30, 31 dhjetor 2022 kanë kaluar në thesar në muajin janar që e cila për ne është llogaritur sipas atrkëtimeve pasi rakordojmë me subjektet per pagesen e taksave.

## Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin

Realizimi i planit të të ardhurave në total është në masën 85%


000/lekë

		Plan viti 2022	Realizimi Viti 2022	Krahasim i ne %
	<b>LLOJET E TË ARDHURAVE</b>			
<b>A</b>	<b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>	<b>75,000</b>	<b>63,881</b>	<b>85%</b>
<b>A.1</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE</b>	<b>18,391</b>	<b>15,576</b>	<b>85%</b>
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël		106	
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	10,375	10,276	99%
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	9,287	6,989	75%
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	343	51	15%
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	745	3,236	434%
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë			
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	50	150	300%
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	7,000	3,300	47%
A.1.5	Taksa e tabelës	966	1,744	181%
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohëshme	-	-	-
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	-	-	-
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	-	-	-
<b>A.2</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)</b>	<b>17,314</b>	<b>19,724</b>	<b>114%</b>
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	185	200	108%
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	10,500	12,456	119%
A.2.3	Taksa e rentës minerare	-	-	-
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	6,200	7,068	114%
A.2.5	Taksa të tjera	429	-	0%
<b>A.3</b>	<b>TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE</b>	<b>35,374</b>	<b>25,973</b>	<b>73%</b>
A.3.1	Tarifa me menaxhimit te mbetjeve	18,900	6,025	32%
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	3,612	484	13%
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	840	287	34%
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	14,448	5,254	36%
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	559	193	35%
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	102	12	12%
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	51	24	47%


A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	406	157	39%	
<b>A.3.4</b>	<b>Tarifa për gjelbërimin</b>	635	279	44%	
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	115	12	10%	
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	61	32	52%	
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	459	235	51%	
<b>A.3.5</b>	<b>Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë</b>	11,339	16,483	145%	
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë				
A.3.5.2	Tarifa për dhënien e liçensave, lejeve e autorizimeve		4,250		
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit				
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura				
A.3.5.5	Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit	639	1,110	174%	
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike				
A.3.5.7	Tarifa për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj				
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat dhe asetet	10,400	10,985	106%	
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shitesë nga zjarrëfiksja	300	45	15%	
0	A.3.5.1	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave		93	
1	A.3.5.1	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille			
2	A.3.5.1	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)			
3	A.3.5.1	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj			
<b>A.3.6</b>	<b>Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj</b>	3,941	2,993	76%	
A.3.6.1	Bibloteka				
A.3.6.2	Muzeumet				
A.3.6.3	Teatri				
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve				
A.3.6.5	Pallati i sportit				
A.3.6.6	Qendra Komunitare				
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)				
A.3.6.8	Kopshtet	1,981	952	48%	
A.3.6.9	Çerdhet	1,960	2,041	104%	
<b>A.3.7</b>	<b>Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime</b>				
<b>A.3.8</b>	<b>Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit</b>				
<b>A.3.9</b>	<b>Tarifa e përkohëshme</b>				
<b>A.3.10</b>	<b>Tarifa të tjera</b>				
<b>A.4</b>	<b>TË ARDHURAT E TJERA</b>	<b>3,921</b>	<b>2,608</b>	<b>67%</b>	
<b>A.4.1</b>	<b>Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë</b>	821	-	-	
<b>A.4.2</b>	<b>Kthimi nga investimet kapitale</b>	-	-	-	
<b>A.4.3</b>	<b>Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë</b>	-	-	-	

A.4.4	<b>Kthimi nga partneriteti publik privat</b>	-	-	-
A.4.5	<b>Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet</b>	-	-	-
A.4.6	<b>Shitja e mallrave dhe shërbimeve</b>	-	-	-
A.4.7	<b>Kundravajtjet administrative (Gjobat)</b>	-	-	-
A.4.8	<b>Sekuestrime dhe Zhdëmtime</b>	-	-	-
A.4.9	<b>Kuotat e anëtarësisë së bashkive</b>	-	-	-
A.4.10	<b>Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore</b>	-	-	-
A.4.11	<b>Grante nga ndihma ndërkombëtare</b>	-	-	-
A.4.12	<b>Shitja e aseteve financiare</b>	-	-	-
A.4.13	<b>Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme</b>	-	-	-
A.4.14	<b>Të tjera</b>	3,100	2,608	84%

Grafiku i mëposhtëm pasqyron përqindjen e realizimit të ardhurave për zërat kryesorë, në raport me planin.



Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas kategorive kryesore.



Zërat kryesorë, që janë me tejkallim në krahasim me planin e vitit 2022 janë të ardhurat nga taksa e tabelës, të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura, të ardhura nga taksa mbi kalimin etë drejtës së pronësisë, të taksa e fjetes ne hotel, të ardhurat nga taksa e truallit, të ardhurat nga tatimi mbi te ardhurat personale si dhe të ardhura nga detyrime të prapambetura.

Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkallim si rezultat i zgjerimit së bazës taksapaguese si dhe rakordimeve korrekte mujore. Gjatë vitit janë kryer kontrole në terren rreth 250 akt-kontrolle. Gjate vitit 2022 si rezultat masave shtrënguese ligjore janë zhbllokuar 20 subjekte dhe jane kryer 87 bllokime llogari bankare. Është e mundur sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i takapagueve nëpërmjet njoftimeve në web, nëpërmjet dërgimit të rreth 420 njoftim-detyrimeve bizneseve, dhe njoftime detyrime familjare rreth 11,024.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksa e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksësë tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturësi rezultat i numrit të ulët të aplikimive për leje ndërtimi.


Nga ana e Bashkisë Mirditë janë marrë masa për gjetjen dhe ndjekjen e rrugëve ligjore për transferimin e shumave përkatëse të palikujduara ne vitet ne vazhdim.

## Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative

Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2022, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik në lekë.

	Lloji I te ardhurave	Totale	Rreshen	Rubik	Fan	Kacinar	Selite	Orosh	Kthelle
<b>1</b>	<b>Taksat vendore</b>	<b>15,574,707</b>	<b>7,391,746</b>	<b>3,358,284</b>	<b>1,369,097</b>	<b>305,744</b>	<b>108,719</b>	<b>2,297,722</b>	<b>743,395</b>
	Ndertese	6,989,193	4,284,921	1,977,406	159,244	9,676	9,784	529,027	19,135
	Truall	3,236,022	420,683	355,962	647,204	226,522	-	1,197,328	388,323
	Token	51,279	6,666	5,641	10,256	3,589	-	18,973	6,153
	Hotel	150,000	50,000	100,000					
	Nd. Infrastruktura	3,297,835	1,747,853	725,524	164,892	65,957	98,935	164,892	329,784
	Tabela	1,743,758	775,004	193,751	387,502			387,502	
	Te tjera taksa vendore	106,620	106,620						
<b>2</b>	<b>Taksat e ndara</b>	<b>19,723,515</b>	<b>6,508,760</b>	<b>5,325,349</b>	<b>2,169,587</b>	<b>1,380,646</b>	<b>394,470</b>	<b>2,366,822</b>	<b>1,577,881</b>
<b>3</b>	<b>Tarifat vendore dhe te tjera</b>	<b>28,582,793</b>	<b>11,224,623</b>	<b>6,243,087</b>	<b>4,309,258</b>	<b>1,098,536</b>	<b>2,197,071</b>	<b>3,342,770</b>	<b>60,244</b>
	Pastrim	6,024,444	2,590,511	1,747,089	120,489			1,506,111	60,244
	Ndricim	192,894	90,660	59,797				42,437	
	Gjelbrim	279,541	131,384	86,658				61,499	
	Leje dhe autorizime	5,360,189	3,216,113	1,608,057	160,806			268,009	
	Qira trualli	10,985,355	1,464,714.00	732,357.00	4,027,963.50	1,098,535.50	2,197,071.00	1,464,714.00	
	Te tjera	5,740,370	3,731,240	2,009,129					


Grafiku paraqet planin dhe realizimin e të ardhurave për secilën Njësi Administrative më vete.



### Analiza e peshës specifike sipas kategorive

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga taksat e ndara me 31% dhe të ardhurat nga taksat vendore 24% dhe te ardhurat nga tarifat vendore me 23% të totalit dhe te tjera 22%.

Grafiku i mëposhtëm peshën e të ardhurave sipas kategorive:




## Analiza e peshës specifike sipas zërave

Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2022 janë zërat taksave ndertesës 7.8% ,taksave mjeteve te perdorura 19%, taksa e truallit 5% taksa e fjetes ne hotel 0.2%,taksa e tokes bujqesore 0.08%, taksa e tabelës ne masen 2.7%,taksa e kalimit te pronësisë ne masen 0.3%, tatimi mbi te ardhurat personale 11%, tarifatat vendore 9.4%,n tarifa e transportit 1.7% ,tarifa e licensimit per tregetim karburanti 6.6%, institucionet kopesht e cerdhe ne masen 4.6% dhenie me qera asetesh 17 %, te tjera 15%

Nr	Lloji i taksës	Pesha Specifike ne %
1	Taksave nderteses	7.8
2	Taksa e mjeteve te perdorura	19
3	Taksa e truallit	5
4	Taksa e fjetjes ne hotel	0.2
5	Taksa e tokes bujqesore	0.08
6	Taksa e tabelës	2.7
7	Taksa e kalimit te drejtes pronesise	0.3
8	Tatimi mbi te ardhurat personale	11
9	Tarifatat vendore	9.4
10	Tarifa e transportit	1.7
11	Tarifa e licensimit per tregitim karburanti	6.6
12	Tarifa nga institucionet kopesht dhe cerdhe	4.6
13	Dhenie me qira asetesh	17
14	Te tjera vendore	15

Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara pëvitin 2022






## Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2022

Falë fokusimit për zgjerim të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, etj., të ardhurat kanë ruajtur një nivelet konstant të arkëtimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe fluiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

leke

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
3,421,308	7,832,020	11,764,216	18,996,964	21,400,402	31,667,190	34,050,352	34,592,036	38,462,373	42,030,792	53,131,581	63,881,014




Referuar arkëtimeve të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Prill, Qershor dhe Dhjetor, periudha të përcaktuara për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi sipas VKB nr.100, datë 24.11.2021 “Për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Mirditë” të ndryshuar dhe falë efektit të njoftimit, sensibilisimit dhe ndjekjes së masave administrative shtrënguese të ushtruara ndaj subjekteve debitore.


leke

Emertimi /000 Lekë	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Totali</b>	<b>25,945,502</b>	<b>53,503,971</b>	<b>40,835,072</b>	<b>57,914,411</b>	<b>64,314,783</b>	<b>57,659,031</b>	<b>70,055,951</b>	<b>63,881,014</b>
<b>Taksat vendore</b>	14,031,040	27,867,288	12,834,718	13,686,560	18,886,208	25,429,386	27,593,239	15,575,006
<b>Taksat e ndara</b>	3,699,020	5,354,599	5,773,184	8,205,992	11,800,713	17,182,974	17,850,478	19,723,515
<b>Tarifatat vendore</b>	4,085,430	7,346,465	9,474,927	13,989,391	10,853,323	15,046,671	7,356,560	14,989,186
<b>Të tjera vendore</b>	4,130,012	12,935,619	12,752,643	22,032,468	22,774,539	0	17,255,674	13,593,306

Krahasuar me vitin 2021, realizimi i të ardhurave ka një rritje me rreth 6,174, mijë Lekë, kjo pasi në 2021 është përfshirë një sponsorizim nga ambasada franceze për shërbimet publike. Ulja e të ardhurave në krahasim edhe me vitin 2019 pasqyron rimëkëmbjen pas krizës dhe pasojave të Covid-19.



### Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë ndër vite



Detyrimi i taksës së pasurisë për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet në arken e bashkisë dhe njesive administrative.

Taksa e ndërtësës, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arketimit deri në vitin 2020 viti në të cilin kemi ulje të kësaj takse në nivelet minimale që parshikon ligji (VKB)

Niveli i arkëtimit ka pasur rritje nga njeri vit ne tjetrin (deri me 2020)nga banesat më shumë ndërtesat për qëllime biznesi. Viti 2022 kanje rritje te ulet ne krahasim me vitin 2021.

Rritja në arkëtimin e të ardhurave nga ndërtesat për qëllimi biznesi, ka ardhur si rezultat i përmirësimit të situtatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Gjate vitit 2022 nuk kemi patur rritje te nr bizneseve.

Taksa e *truallit*, krahasuar me vitin e kaluar, është ne nivele arkëtimi me te larte se viti 2021 si rezultat i arketimeve nga perdorimit i truallit per qellime biznesi.

Taksa e *tokës bujqësore*, krahasuar me vitin e kaluar eshte pothuajse ne ato nivele dhe mbetet shqetesim arsye e mos marrjes se tokes në pronësi nga subjektet familje ne fshat.


Po punohet ne zgjerimin i bazës taksapaguese dhe rritja e arkëtimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve tëkapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terrenme subjektet dhe familjarët, nxitjes së vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese, nxitëse e sensibilizuese të bashkisë

Tatim fitimi i biznesit të vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, dhe Ligjit Nr. 122/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar arkëtohet nga bizneset e vogla,dhe mëpas i transferohet bashkisë nga drejtoria tatimore, në rolin e agjentit tatimor.

Kjo taksë zë një minimal ne te ardhurat te bashkisë per arsye te lehtesirave ligjore. Në raport me vitin e kaluar kjo taksë ka një rënie në arkëtim.

Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, dhe faturohen bazuar në monitorimet dhe verifikimet e herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve në terren. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat kanë një rritje prej 150,000 leke.. Kjo ka ardhë si rrjedhojë e rritjes së kapaciteteve të bizneseve, rihapjes graduale pas pandemisë globale COVID-19 dhe rinisjes së lëvizjevetë transportit të udhëtarëve brenda vendit gjatë periudhës së verës. Në qoftë se do ta krahasojmë me vitet e kaluara vihet re një trend i përafritimit të vlerës së arkëtuar me vitet e tjera.

Taksa e tabelës për qëllime reklamimi,krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje prej +592 mij Lek, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjitNr. 106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, me efekt uljen e bazës sëtaksës referuar aneksit Nr. 7 të këtij Ligji



## Taksat e ndara

Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë administrohet nga ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës), në rolin e agjentit tatimor. Taksa mbledhet nga agjenti tatimor i cili ia transferon të ardhurat e grumbulluara bashkisë. Krahasuar me vitin e kaluar kjo ka një shtesë të papërfillshme.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, ku përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimorë. Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton një rritje e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë +1,955 mijë lekë, që është krijuar si realizat i rritjes së numrit të automjeteve që aplikojnë për regjistrim pranë zyrave të DRShTRr.

Taksa e rentës minerare që grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, dhe shpërndahet si taksë e ndarë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si taksë e ndarë, duhet t’ transferohet 2% bashkisë. Per 2 vite rresht 2021-2022, bashkisë iu transferua 13,370 mijë lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka transferuar vlerë prej 7,067 mijë lekë në favor të bashkisë.

Në total të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar 1,873 mijë lekë më shumë se vitin e kaluar,

## **Tarifat**

Tarifat vjetore të pastrimit në total arrijnë vlerën e arketuar prej 6,024 mijë lek ,kjo ka renie në krahasim me vitin e kaluar kjo vjen si rezultat i mosarektimit te tarifave familjare bashke me detyrimet debitore per efekt te lehtesirave fiskale miratuar ne keshillin Bashkiak dhe perjashtimet perkatëse.

Tarifat vjetore të ndriçimit, dhe gjelbërimit është arkëtuar ne nivele te ulta shak është ato që u përmenden më lart.

Tarifa për dhënie me qera të trojeve sipas kontratev ete lidhura janë arkëtuar 10,985 mije leke për vitin 2022 ne krahasim me vitin 2021 kjo është në pak për arsye të mbarimit të kontratve 5-vjecare me subjekte përkatëse.

Tarifa per dhënie autorizime te karburateve është ne vleren 4,250 mije lekë për arsye të paisjes me licenca 5-vjecare te subjekteve ekzistuese pasi ishte koha e rinovimit të tyre.


Të ardhurat e tjera burojnë nga gjobat, kamatvonesat, qira etj,për vitin 2022 janë grumbulluar 394 mijë lekë. Krahasuar me vitet e kaluara, të ardhurat kanë pasur një rritje për efekt te kamatave per mospagese ne afat te detyrimeve.


#### 4. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2022

Buxheti i Bashkisë Mirditë, gjatë vitit 2022, nga të gjitha burimet e financimit, u realizua në shumën 1 992 320 mijë lekë, me nivel realizimi 94.27%.

Emertimi	000/leke		
	Plani Korrigjuar	Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	287,018	279,691	97.45%
Shpenz.Operative	125,285	102,186	81.56%
Transferime	427,120	398,174	93.22%
Investime	1,273,961	1,212,269	95.16%
<b>Totali</b>	<b>2,113,384</b>	<b>1,992,320</b>	<b>94.27%</b>


Realizimi i shpenzimeve, ne 000/leke, me te gjitha burimet e financimit





Peshen me te madhe të realizimit në përqindje e zënë investimet që janë, në masën 61 % në shumën 1 212 269 mijë leke. Pjesa me e madhe e këtyre investimeve është nga fondet e rindertimit.

#### Pesha specifike e shpenzimet totale per vitin 2022







Shpenzimet per paga rreth 49 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta (qe jane transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e realizuara nga vete bashkia) , rreth 49 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, dhe 2 % me Transferte te Kushtezuar(qe jane gjendja civile dhe QKB).

Shpenzimet operative rreth 89 % jane realizuar me Burimet e veta, 8 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale dhe 3 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 98 % (bonus qeraje per familjet e demtuara nga termeti i dates 29.11.2019, PAK +NDE dhe fondi i emergjenceve) , me Burimet e veta 1 % (per shperblime dalje ne pension dhe ndihme financire nga fondi rezerve i bashkise per raste familjeve ne nevoje) dhe me Transferte e pakushtezuar sektoriale 1 % (perdorimi i fondit te emergjences sipas rastet e miratuara me VKB)

Shpenzimet per investime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 69 %(grand rinderimi qe perfshine investimet ne objekte shkollore, publike dhe ambiente te perbashketa ne qytet Rreshen, Rubik dhe Repts dhe ndertimi i ujsjellsit rubik me fonde te MIE) ,me Burimet e veta 28 % dhe me Transferte e pakushtezuar sektoriale 3 %

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:





Realizimi i shpenzimeve per te gjitha programet ne **000/leke** , ne periudhen vitin 2022 ne Matrice paraqitet si me poshte:

		Paga dhe Sigurime			Shpenzime operative			Transferime			Investime			Totali		
Prog rami	EMERTIMI	Plani fillestar 2022	Plani korrigjuar 2022	Realizimi 2022	Plani fillestar 2022	Plani korrigjuar 2022	Realizimi 2022	Plani fillestar 2022	Plani korrigjuar 2022	Realizimi 2022	Plani fillestar 2022	Plani korrigjuar 2022	Realizimi 2022	Plani fillestar 2022	Plani korrigjuar 2022	Realizimi 2022
		Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	42,180	42,115	41,710	14,343	15,743	15,445	3,244	2,990	2,989	-	300	-	59,767	61,148	60,144
01120	Çeshtje Financare dhe Fiskale	15,224	14,161	14,120	3,930	2,599	2,146	-	1,375	1,192	-	-	-	19,154	18,135	17,458
01170	Gjendja civile	4,736	4,736	4,523	-	-	-	-	120	120	-	-	-	4,736	4,856	4,643
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	8,085	8,085	8,083	360	360	342	-	-	-	-	-	-	8,445	8,445	8,425
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	16,618	16,552	16,030	3,209	3,408	2,782	-	347	337	-	-	-	19,827	20,307	19,149
04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	830	830	830	50	50	46	-	10	-	-	-	-	880	890	876
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	6,201	6,051	5,165	35	35	30	-	150	150	-	-	-	6,236	6,236	5,345

04240	Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	4,602	4,065	3,901	2,928	1,798	1,589	-	167	162	8,625	22,074	13,166	16,155	28,104	18,818
04260	Administrim i pyjeve dhe kullotave	12,137	12,137	11,538	1,035	1,877	1,417	-	330	330	4,828	6,199	-	18,000	20,543	13,285
10140	Punonjesit social	8,794	8,794	8,593	159	159	77	-	-	-	-	-	-	8,953	8,953	8,670
04760	Zhvillimi I Turizmit	2,537	2,537	2,519	259	259	241	-	-	-	-	-	-	2,796	2,796	2,760
04520	Rrjeti rrugor rural	32,516	33,516	32,517	9,313	8,365	8,365	-	860	860	23,000	23,000	9,456	64,829	65,741	51,198
06140	Planifikimi Urban Vendor	8,935	8,935	8,555	840	340	140	-	-	-	-	672	672	9,775	9,947	9,367
06260	Sherbimet Publike	10,535	16,536	16,344	47,563	44,945	39,362	-	1,551	1,551	1,941	1,941	1,941	60,039	64,973	59,198
06330	Furnizimi me ujë	-	-	-	-	462	457	-	-	-	-	19,442	3,388	-	19,904	3,845
08130	Sport dhe Argetim	2,376	2,376	2,189	2,018	2,289	2,220	-	50	50	-	-	-	4,394	4,715	4,459
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	8,142	7,912	7,499	160	160	160	-	230	230	-	-	-	8,302	8,302	7,889
08230	Integrimi Evropjan & ndihmes se huaj	698	698	698	-	-	-	-	-	-	-	-	-	698	698	698
09120	Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Baze	65,207	62,997	61,602	19,437	33,739	21,444	-	2,268	2,245	5,112	5,112	5,112	89,756	104,116	90,403
09230	Arsimi i mesem i pergjithshem	7,798	7,798	7,556	2,112	1,852	1,350	-	494	494	3,233	3,233	3,233	13,143	13,377	12,633

09240	Konvikti	17,519	16,519	16,391	4,597	5,137	3,127	-	460	460	-	-	-	22,116	22,116	19,978
10430	Kujdesi Social per femijet	9,668	9,668	9,328	484	256	128	-	229	228	-	-	-	10,152	10,153	9,684
10 09240	Konvikti	-	-	-	-	1,452	1,318	-	1,215	1,163	-	-	-	-	2,667	2,481
13 10430	Ndihma ekonomike dhe PAK	-	-	-	-	-	-	-	301,629	299,019	-	-	-	-	301,629	299,019
00 10910	Emergjencat Civile	-	-	-	-	-	-	-	3,247	3,004	-	-	-	-	3,247	3,004
17 10910	fondi I mbrojtjes civile	-	-	-	-	-	-	-	6,483	6,483	-	-	-	-	6,483	6,483
06 06370	Ujesjelles dhe Kanalizime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	20,350	20,350	-	20,350	20,350
10 06190	Bonus qeraje per te pastrehet dhe termetin transferte	-	-	-	-	-	-	-	45,284	45,284	-	-	-	-	45,284	45,284
00 06190	Grand Rindertimi	-	-	-	-	-	-	600	1,147	584	-	-	-	600	1,147	584
00 04960	Grand Rindertimi	-	-	-	-	-	-	-	54,853	31,239	-	1,167,638	1,153,949	-	1,222,491	1,185,188
00 01810	Fond emergjence, kontigjence dhe rezerve	-	-	-	-	-	-	3,500	1,631	-	-	-	-	3,500	1,631	-
04530	Menaxhimi i rrugëve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4,000	4,000	1,002	4,000	4,000	1,002
	<b>TOTALI</b>	<b>285,338</b>	<b>287,018</b>	<b>279,691</b>	<b>112,832</b>	<b>125,285</b>	<b>102,186</b>	<b>7,344</b>	<b>427,120</b>	<b>398,174</b>	<b>50,739</b>	<b>1,273,961</b>	<b>1,212,269</b>	<b>456,252</b>	<b>2,113,384</b>	<b>1,992,320</b>

**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

BASHKIA MIRDITE


12 - mujori Viti 2022

ne 000/leke

Emri i Grupit		BASHKIA MIRDITE				Kodi i Grupit	133	
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli	Emertimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	PBA Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës /progresiv	Fakti i Periudhës /progresiv	Diferenca
01110	Planifikim Menaxhim dhe Administrim	63,983	53,506	59,767	61,148	61,148	60,144	(1,004)
01120	Çeshtje Financare dhe Fiskale	30,722	45,550	19,154	18,135	18,135	17,458	(677)
03140	Sherbimi i Policise Vendore	9,622	12,439	8,445	8,445	8,445	8,425	(20)
03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	18,427	16,180	19,827	20,307	20,307	19,149	(1,158)
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	8,584	13,917	6,236	6,236	6,236	5,345	(891)
04240	Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	6,115	13,611	16,154	28,104	28,104	18,818	(9,286)
04260	Administrim i pyjeve dhe kullotave	13,363	13,557	18,000	20,543	20,543	13,285	(7,258)
04570	Transport Publik	948	1,035	-	-	-	-	-
04760	Zhvillimi I Turizmit	2,097	2,669	2,796	2,796	2,796	2,760	(36)
04520	Rrjeti rrugor rural	47,570	91,591	64,829	65,741	65,741	51,198	(14,543)
06140	Planifikimi Urban Vendor	11,398	11,378	9,775	9,947	9,947	9,367	(580)
06260	Sherbimet Publike	68,080	45,820	60,039	64,973	64,973	59,198	(5,775)
06330	Furnizimi me ujë	6,583	-	-	19,904	19,904	3,845	(16,059)
08130	Sport dhe Argetim	4,368	5,523	4,394	4,715	4,715	4,459	(256)

08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	7,648	7,819	8,302	8,302	8,302	7,889	(413)
08230	Integrimi Evropjan & ndihmes se huaj	669	-	698	698	698	698	-
09120	Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Baze	85,796	75,678	89,756	104,116	104,116	90,403	(13,713)
09230	Arsimi i mesem i pergjithshem	11,557	8,500	13,143	13,377	13,377	12,633	(744)
09240	Konvikti	21,647	21,881	22,116	22,116	22,116	19,978	(2,138)
10140	Punonjesit Social	-	-	8,953	8,953	8,953	8,670	(283)
10430	Kujdesi Social per femijet	8,652	9,447	10,152	10,153	10,153	9,684	(469)
01170	Gjendja Civile	4,706	4,736	4,736	4,856	4,856	4,643	(213)
04130	QKB	797	864	880	890	890	876	(14)
10 09240	Konvikti	3,169	-	-	2,667	2,667	2,481	(186)
13 10430	Ndihma ekonomike dhe PAK	290,184	-	-	301,629	301,629	299,019	(2,610)
00 10910	Emergjencat Civile	4,040	-	-	3,247	3,247	3,004	(243)
73 01620	Zgjedhje të Përgjithshme dhe Lokale	2,130	-	-	-	-	-	-
11 08140	Zhvillimi i Sportit	733	-	-	-	-	-	-
06 06370	Ujesjelles dhe Kanalizime	25,200	-	-	20,350	20,350	20,350	-
17 10910	fondi I mbrojtjes civile	-	-	-	6,483	6,483	6,483	-
10 06190	Bonus qeraje per te pastrehet dhe termetin transferte	38,767	-	-	45,284	45,284	45,284	-
00 06190	Grand Rindertimi	1,203	-	600	1,147	1,147	584	(563)
00 04960	Grand Rindertimi	211,559	-	-	1,222,491	1,222,491	1,185,188	(37,303)
00 01810	Fond emergjence, kontigjence dhe rezerve	-	-	3,500	1,631	1,631	-	(1,631)
04530	Menaxhimi i rrugëve	3,044	-	4,000	4,000	4,000	1,002	(2,998)
<b>Totali i Shpenzimeve te Ministrise</b>		<b>1,013,361</b>	<b>455,701</b>	<b>456,252</b>	<b>2,113,384</b>	<b>2,113,384</b>	<b>1,992,320</b>	<b>(121,064)</b>
<b>Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>		<b>1,013,361</b>	<b>455,701</b>	<b>456,252</b>	<b>2,113,384</b>	<b>2,113,384</b>	<b>1,992,320</b>	<b>(121,064)</b>

## Pesha specifike e programeve ne realizimin e vitit 2022



## Treguesit Kyç Financiar 2022

Nr.	Treguesit kyç financiarë	Kuptimi	Formula	Fakti viti 2021	Plani	Plani	Plani	Plani
					2022	2023	2024	2025
1*	Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme	Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave– raporti tregon sesa shpenzon njësia për ofrimin e shërbimeve publike. Tregon marrëdhënien midis flukseve hyrëse të të ardhurave me flukset dalëse të shpenzimeve.	Shpenzimet e përgjithshme /Të ardhurat e përgjithshme	95%	100%	100%	100%	100%
2*	Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme	Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Rritja e raportit në vite tregon se njësia nuk mbështetet vetëm në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)	Të ardhura nga burimet e veta / Të ardhurat e përgjithshme	7%	7%	15%	15%	15%
3*	Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj planit të tyre	Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë është e përleshme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.	Te ardhura faktike nga taksat & tarifatat vendore /Te ardhura te planifikuara nga taksat & tarifatat vendore	84%	100%	100%	100%	100%
4*	Raporti I shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Një normë e lartë një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore. Rritja e raportit përgjatë viteve mund të shpjegohet edhe me shërbime shtesë, infrastrukturë e re, pasuri të paluajtshme të shtuara, funksione të reja të marra që kanë nevojë për investime etj.	Shpenzimet kapitale / Shpenzimet e përgjithshme	25%	49%	11%	11%	11%

5*	Raporti I shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Rritja në vite e peshës së shpenzimeve të personelit ndaj shpenzimeve të përgjithshme mund të tregojë ulje të shpenzimeve për investime/operative, ose faktin se produktiviteti i personelit është në rënie. Një rritje e këtijraport mund të tregojë gjithashtu se qeveria po ofron më shumë shërbime (duke marrë funksionet të reja, duke rritur volumin e shërbimeve ose cilësinë e tij)	Shpenzimet e personelit / Shpenzimet e përgjithshme	27%	33%	72%	72%	72%
